



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 700, datë 30.11.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, PËR VITIN 2022

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
 2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

1-A Njohuritë ligjore.

1-A-a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Gjyqtarja, referuar natyrës së gjykimit (gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale) apo llojit të gjykimit të zhvilluar, i kushton rëndësi përcaktimit të detajuar të fakteve të çështjes dhe përshkrimit të tyre në një ose disa pjesë të arsytimit të vendimit, në varësi të volumit të rrethanave të faktit apo natyrës së gjykimit sipas kërkesës objekt shqyrtimi.

Identifikon natyrën penale të kërkesës, duke e cituar atë në pjesën hyrëse dhe përshkruese-arsyetuese të vendimit

Në vendimet e themelit dhe ato me objekt “Dërgimin e çështjes në gjyq” apo “Pushimin e procedimit penal”, gjyqtarja, në pjesën e parë të arsytimit të titulluar “*Procedura, faktet dhe provat*” apo “*faktet dhe provat*”, përshkruan fillimisht kronologjinë e ngjarjes mbi të cilën mbështetet fakti penal si dhe veprimet e kryera nga i pandehuri duke i integruar provat me faktet e çështjes. Elementë të faktit penal bëhen pjesë e analizës së elementëve të figurës së veprës penale në pjesën e titulluar “Vlerësimi i gjykatës”, pjesë në të cilën gjyqtarja analizon ekzistencën e elementeve të veprës penale duke marrë në analizë secilin prej tyre (*objektin, anën objektive, subjektin, ana subjektive*) dhe analizën e llojit dhe masës së dënimit.

Në vendimet penale të analizuara, nëpërmjet të cilave është vendosur deklarimi fajtor dhe dënimi i të pandehurit, gjyqtarja evidenton dhe analizon edhe faktet të cilat ndikojnë në individualizimin e dënimit.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, referuar kategorisë së çështjes, natyra juridike e çështjes është e qartë dhe rezulton nga objekti i gjykimit (*gjykim themeli, kërkesë për dërgim në gjyq, pushimin e procedimit penal ose shfuqizim i vendimit të prokurorisë për “Mosfillimin e procedimit penal*), duke u evidentuar në disa raste në mënyrë të shprehur, si një element që orienton gjykatën në evidentimin e juridiksionit, kompetencës, detyrimit të gjykatës për njoftimin e kërkesës subjekteve procedurale (*të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës dhe trashëgimtarëve kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim*), analizën ligjore të çështjes, sipas natyrës së saj... etj.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural:

- identifikon dispozitat proceduralë penale të aplikueshme: nenet 69, 13/1, 74, 76 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore e tokësore; nenet 332 dhe 332/a të Kodit të Procedurës Penale¹ (*të cituara në të gjitha vendimet burim vlerësimi*)
- neni 332/a/1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me shqyrtimin e kërkesës në mungesë të të pandehurit duke qenë se kishte dijeni për datën dhe orën e seancës; nenin 403 të Kodit të Procedurës Penale, nenin 110/2 të Kodit të Procedurës Penale nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me elementët formalë që duhet të përmbajë kërkesa për kalimin e çështjes në gjyq; nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me vlefshmërinë e kërkesës për kalimin e çështjes në gjyq; nenin 331/4 i Kodit të Procedurës Penale lidhur me bashkëlidhjen e akteve dhe provave që përmban fashikulli i hetimit, si dhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake; nenin 332/ë/2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me aktet e hetimeve paraprake që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit;
- nenin 178 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me ndalimin për përcaktimin e prirjeve kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit;
- nenin 179 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me vendimin për caktimin e ekspertimit në fazën e hetimeve paraprake; nenin 128/a të Kodit të Procedurës Penale

¹ *Cituar në të gjitha vendimet burim vlerësimi*

lidhur me pavlefshmërinë absolute të akteve; nenin 129 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me pavlefshmërinë relative; nenin 181 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me përjashtimin e ekspertit; nenin 403/2 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me moslejimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar për veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.²

- nenet 13/2 pika ç, 69, 74, 76 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me juridiksionin, kompetencën lëndore e tokësore;
- nenet 329/a dhe 329/b të Kodit të Procedurës Penale lidhur me caktimin e seancës paraprake dhe njoftimin e subjekteve procedural (Prokuror, person nën hetim, viktimë) dhe lënien kohë në dispozicion për të paraqitur memorie ose akte, si dhe për tu njohur me aktet;
- nenin 328 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me rastet kur vendoset pushimi i akuzës ose çështjes;³
- nenin 405/7 i Kodit të Procedurës Penale lidhur me vendimmarrjen për pranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar⁴.
- nenet 6, 49, 332/b të Kodit të Procedurës Penale lidhur me caktimin e një mbrojtësi kryesisht për të pandehurin; nenin 331 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me elementët formalë që duhet të përmbajë kërkesa për kalimin e çështjes në gjyq;⁵
- nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me të drejtën e ushtrimit të kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal dhe shqyrtimin e ankesës në dhomë këshillimi, referuar ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale me Ligjin nr. 41/2021.⁶
- nenin 278 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me të drejtën e gjykatës për të vendosur gjatë hetimeve paraprake mbi kërkesat e prokurorit, të dëmtuarit, të pandehurit; nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me qenien përpara ndonjë prej kushteve të mosfillimit të procedimit penal;⁷

² Vendimin nr. 3187 Regj., datë regj. 30.09.2022, datë vendimi 01.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjyqtari i Seancës Paraprake me objekt: Dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit L.Z i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit" të parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal.),

³ Vendimin nr. 1744 regj., datë regj. 08.09.2022, datë vendimi 21.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Pushimin e çështjes penale për personin nën hetim P.Ç i dyshuar për kryerjen e veprës penale "Ngacmimi seksual" parashikuar nga neni 108/a,2 i Kodit Penal.

⁴ Në Vendimin nr. 2076, datë 26.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Gjykimin e çështjes penale, në ngarkim të të pandehurës G.SH e akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Braktisja e fëmijës së mitur" parashikuar nga neni 124/1 i Kodit Penal.).

⁵ Në Vendimin nr. 2529, datë 01.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Gjykimin e çështjes penale, në ngarkim të të pandehurës K.P e akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhja" parashikuar nga neni 134/1 i Kodit Penal.,

⁶ Vendimin nr. 1292 regj., datë regj. 13.06.2022, datë vendimi 08.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për "Mosfillimin e procedimit penal" me Nr. 1901 të vitit 2022 dhe vazhdimin e hetimeve.

⁷ Vendimin nr. 1745 regj., datë regj. 08.09.2022, datë vendimi 25.10.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Pushimin e çështjes penale për personin nën hetim S.K i akuzuar për kryerjen e veprës penale "Dhuna në familje" parashikuar nga neni 130/a/2/4/2/4 i Kodit Penal. Caktimin e masës mjekësore "Mjekim i detyruar ambulator" ndaj shtetasit S.K, nën kujdesin e një familjari

- citon dhe aplikon nenin 485 të Kodit të Procedurës Penale duke disponuar mbi shpenzimet gjyqësore përmes ngarkimit të pandehurit të shpallur fajtor.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në shmangien e citimit apo të listimit të dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, konstatohet se:

- nenin 79/b të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit”.
- nenin 108/a të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Ngacmimi seksual”.
- nenin 124/1 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të “*Braktisja e fëmijës së mitur*”;
- nenin 291 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”.
- nenin 242 të Kodit Penal lidhur me figurën e veprës penale të “Mosbindja ndaj urdhrimit të punonjësit të policisë së rendit publik”.
- nenin 134/1 të Kodit Penal lidhur me veprën penale të “Vjedhjes”;
- nenin 47 të Kodit Penal lidhur me individualizimin e dënimit;
- nenet 58-65 të Kodit Penal lidhur me alternativat e dënimit me burgim;
- nenin 59 të Kodit Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë;
- nenin 60/9 të Kodit Penal lidhur me përcaktimin e detyrimit për të mos u shoqëruar me persona të dënuar;
- nenin 60/3 të Kodit Penal lidhur me detyrimin për të riparuar dëmin civil të shkaktuar në masën e pranuar nga vetë e pandehura;
- nenin 62 të Kodit Penal lidhur me paralajmërimin e pasojës nëse nuk përmbushen detyrimet e vendosura nga Gjykata; nenin 14 të Kodit Penal lidhur me fajin si element i përgjegjësisë penale.
- nenin 148/1 të Kushtetutës lidhur me ushtrimin e ndjekjes penale si detyrë ekskluzive e shtetit;
- nenin 130/a/2/4/2/4 i Kodit Penal (*Dhuna në Familje*)

Krahas dispozitave të Kodit Penal, dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe dispozitat e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës si më poshtë:

- Rekomandimin Nr. R (99) 22 të Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve të Këshillit të Evropës mbi popullimin e burgjeve paragrafi 1 dhe paragrafi 14.
-

- GJEDNJ Guliani &Gaggio kundër Italisë, për të vlerësuar provat e faktit, gjykata adapton standardin e te provuarit “për tej çdo dyshimi te arsyeshëm, por shton se prova te tjera;
- nenin 39 të Kushtetutës lidhur me parimin se askush nuk mund të akuzohet ose deklarohet fajtor për një veprë që nuk konsiderohej e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj; nenin 2 të Kodit Penal lidhur me mosdënimin pa ligj;
- Neni 148 /1 I Kushtetutës në lidhje me rolin e prokurorisë ne ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj;
- Neni 42 i Kushtetues ne lidhje me kontrollin parapake të kontrollit gjyqësore, lidhur me të drejtën për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, përmes një autoriteti të pavarur dhe të paanshëm.
- Vendimi Unifikues nr.2 date 20.06.2013 i Kolegjeve të Bashkuara;
- Vendimin Unifikues nr. 7 datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm të akuzës.

Sa i përket konfliktit të normave, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast i konfliktit të normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZION

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës të qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, duke i integruar dhe me një analizë të detajuar të provave. Evidentohen aftësitë e gjyqtares në lidhje me identifikimin dhe përcaktimin e ligjit të zbatueshëm, duke referuar ose cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1-A-b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Nga vëzhgimi i burimeve të vlerësimit konstatohet se gjyqtarja, referon, citon dhe interpreton normat e ligjit procedural dhe material të zbatueshëm mbi faktet e çështjes, në shërbim të analizës ligjore dhe zbatimit të tyre në zgjidhjen e çështjes konkrete.

Nga vendimet gjyqësore burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja nuk është mjaftuar vetëm me citimin e dispozitës ligjore të zbatueshme, por ka analizuar dhe interpretuar dispozitat në kuadër të fakteve të çështjeve objekt gjykimi, duke zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe proceduralë që gjejnë aplikim në çdo rast konkret.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

Gjyqtarja {...} në çdo vendim interpreton dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e veprës si dhe interpreton normën, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale si dhe duke i ndërthurur me faktet dhe provat e rezultuara gjatë gjykimit, në funksion të konkluzioneve të arritura. Analizohen në katër elementët e figurës së veprës penale dispozitat e pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjyqtarja interpreton dispozitën materiale:

- Nenin 134/1 i Kodit Penal në funksion të cilësimit juridik të veprës penale duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e kësaj figure vepre penale, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.
- Nenin 108/a,2 të Kodit Penal duke analizuar elementët e figurës së veprës penale të “Ngacmimi seksual” në të katër elementët e saj objekti, ana objektive, subjekti, ana subjektive.
- Neni 76 i Kodit Penal interpretim të cilin gjykata nuk e bën vetëm teorikisht duke identifikuar dhe analizuar të katër elementët e kësaj figure vepre penale, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim.

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale ;

- Interpreton nenet 128/a dhe 129 të Kodit të Procedurës Penale, në aspektin qëllimor të tyre, për të cilat shprehet se kanë karakter garantues dhe synojnë të realizojnë drejtpeshimin e nevojshëm mes nevojës për efektivitet dhe shpejtësi të procedurave gjyqësore dhe të drejtës së palës së akuzuar, për të mos u gjykuar mbi bazën e akteve të pavlefshme, që prekin interesat e saj.
- Interpreton teleologjikisht dhe literalisht nenin 128/a të Kodit të Procedurës Penale duke theksuar se kjo dispozitë parashikon parimin e taksativitetit, pra aktet janë të pavlefshme vetëm në rastet e parashikuara shprehimisht në Kodin e Procedurës Penale.
- Interpreton nenin 178/2 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit ndalohet kryerja e ekspertimeve për të përcaktuar prirjet kriminale, karakterin dhe personalitetin e të pandehurit dhe në përgjithësi cilësitë psikike që nuk varen nga shkaqet patologjike, për të vendosur mbi mospranimin e plotësisht të hetimeve të kërkuara nga mbrojtja

sa i takon pretendimit për kryerjen e një akti ekspertimi shtesë lidhur me karakteristikat e personalitetit të të pandehurit.

- Interpreton literalisht dhe sistematikisht nenet 332/c/3 dhe 403/2 të Kodit të procedurës Penale për të vendosur mospranimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar, pasi akuza e ngritur parashikon dënim me burgim të përjetshëm.⁸
- Interpreton dhe analizon nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale si e drejtë e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të.⁹
- Analizon nenin 331 të K.Pr.Penale, duke evidentuar elementët e vlefshmërisë së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante, në shumicën e vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht në vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja citon, analizon dhe interpreton;

- Interpreton nenin 148/1 të Kushtetutës lidhur me ndjekjen penale si një detyrë ekskluzive të shtetit, ku një nga detyrat kryesore të këtij të fundit është respektimi i kuadrit normativ, përmes sigurimit të një drejtësie penale funksionale.
- Interpreton në mënyrë sistematike nenin 39 të Kushtetutës dhe nenet 1 e 2 të Kodit Penal, duke përcaktuar se e vetmja bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet ose mosveprimet e tij të ekzistojnë elementët e një figure të caktuar të veprës penale të parashikuar nga ligji penal.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës ;

Në vendimet e vëzhguara, evidentohet se gjyqtarja, i kushton një rëndësi të veçantë zbatimit të parimeve të përgjithshme të së drejtës, duke mos u mjaftuar vetëm me zbatimin dhe interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjes, por duke përmendur dhe zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës si;

- Parimin e barrës së provës së organit të akuzës, për të provuar akuzën dhe për t'i krijuar bindjen “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” se vepra penale është kryer dhe është kryer nga e pandehuri.

⁸ Në Vendimin nr. 3187 Regj., datë regj. 30.09.2022, datë vendimi 01.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjyqtari i Seancës Paraprake (me objekt: Dërgimin për gjykim të procedimit penal në ngarkim të të pandehurit L.Z i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasja e punonjësve të policisë së shtetit” të parashikuar nga neni 79/b i Kodit Penal.)

⁹ Në Vendimin nr. 1292 regj., datë regj. 13.06.2022, datë vendimi 08.07.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (me objekt: Shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për “Mosfillimin e procedimit penal” me Nr. 1901 të vitit 2022 dhe vazhdimin e hetimeve.),

- Parimin e prezumimit të pafajësisë të parashikuar nga neni 4 i Kodit të Procedurës Penale.
- Parimi i individualizimit të dënimit, parimi se ashpërsia e një penaliteti për një veprë penale të kryer, duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale me ashpërsinë e veprës penale.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja {...} ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

I-B Arsyetimi ligjor

I-B-a Qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe shpesh herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës. Vendimi përgjithësisht është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër dhe duke e numërtuar. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmanget përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (*gjithmonë konstatohet përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”*).

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine (*Citohen "ratione loci; ratione personae; ratione materia; ratione temporis; sine qua non; actus rea; nullum crimen, nulla poena sine legge; nullum crimen, nulla poena sine culpa, extrema ratio*), përgjithësisht të etiketuara në thonjëza, pas termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshëm për lexuesin. Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsytimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues, vlerësohet "Shumë e lartë", duke u pikëzuar me 15 pikë.*

I-B-b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Gjyqtarja i harton vendimet e saj me strukturë të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Vendimet e vëzhguara respektojnë me rigorozitet strukturën formale me tre pjesë të vendimit, por edhe elementët e çdo pjese, siç përcakton 383 i Kodit të Procedurës Penale. Çdo vendim gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit dhe gjykata që ka gjykuar çështjen, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit dhe baza ligjore, si dhe kërkimet përfundimtare të palëve të pranishme në proces.

Në pjesën përshkruese-arsyetuese: është e ndarë në paragrafë të titulluar *1-Procedura* - në pjesën hyrëse të vendimeve burim vlerësimi gjyqtarja pas prezantimit të çështjes, parashtron faktet me natyrë procedurale lidhur me trajtimin e çështjeve të juridiksionit dhe kompetencës, trajtimin e kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit pra gjen pasqyrim në mënyrë të strukturuar procedura e ndjekur, me pas vjen pjesa e titulluar *2-Faktet dhe provat*, ku gjyqtarja parashtron faktet dhe rrethanat e çështjes si dhe *3-Vlerësimi i gjykatës* si pjesë e tretë pjesës përshkruese arsyetuese, ku merret në analizë ligji i

zbatueshëm, elementët e tij në lidhje me faktet konkrete, dhe në fund konkluzioni i gjyqtares për zgjidhjen e çështjes.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me fajësinë, dënimin dhe vendin e ekzekutimit të tij për të pandehurin, shpenzimet gjyqësore, e drejta e ankimit, si dhe data e shpalljes së vendimit gjyqësor si dhe e drejta e ankimit. Në çështjet e kategorisë “seancë paraprake”, gjen pasqyrim disponimi i gjykatës në lidhje me: fatin e çështjes; formimin e fashikullit të gjykimit duke cituar dhe se çfarë duhet të përmbajë ky fashikull; depozitimin e vendimit sëbashku me fashikullin e gjykimit në sekretarinë e gjykatës; faktin se ndaj vendimit nuk lejohet ankim; si dhe data e shpalljes së vendimit gjyqësor.

Konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, elementët e parashikuar në: (i) nenin 260 të K.Pr.Penale, në vendimin e kërkesës së fazës së hetimit paraprake, (ii) nenin 332/e dhe 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet seancë paraprake, (iii) nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e strukturuar mirë, gjithmonë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e të gjitha palëve ndërgjyqëse, ligji i zbatueshëm, vlerësimi i gjykatës dhe përfundimet e arritura nga gjyqtarja. Në përgjithësi konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

I-B-c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në të gjitha vendimet e analizuar te gjyqtares, rezulton se arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal. Gjyqtarja tregon një kujdes të veçantë gjatë arsyetimit për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithëpërfshirës duke i dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve në proces.

Gjyqtarja i kushton rëndësi analizës së instituteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.:

- Interpreton institutin e dënimit, si një masë shtrënguese që zbatohet nga shteti, përmes gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprë penale.
- Trajton institutin e pezullimit të ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të parashikuar në nenin 59 të Kodit Penal.

Në vendimet e analizuara, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi dhe kujdes të posaçëm analizës së plotë dhe të qartë të faktit penal së bashku me përshkrimin e ecurisë procedurale të çështjes dhe hapat që ka ndjekur procedimi penal, e pasqyruar kjo në pjesën e parë të pjesës përshkruese arsyetuese. Ndërsa në pjesën e dytë gjyqtarja i kushton rëndësi paraqitjes dhe analizës së plotë dhe logjike e provave, duke i integruar ato me analizën ligjore të dispozitave të zbatueshme, si në lidhje me aspektet procedurale ashtu edhe në raport me elementet e faktit penal, i jep arsyetimit qartësi dhe zhvillim logjik.

Gjyqtarja integron në mënyrë logjike dispozitat ligjore të zbatueshme, të cilat kryesisht pas citimit ose referimit të tyre, shoqërohen me interpretim dhe më pas me zbatim mbi faktet e çështjes, duke pasuruar argumentimin logjik me qëndrimet e praktikës gjyqësore.

Në secilin vendim penal të analizuar, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit apo llojit të çështjes (*gjykim themeli, kërkesë e fazës së hetimit paraparak*), analiza dhe arsyetimi shtjellohen në mënyrë logjike. Paraqitja dhe analiza e elementëve të faktit penal në lidhje me veprën penale si dhe autorësinë, si në pjesën ku fakti paraqitet në një nënndarje të veçantë, ashtu edhe në pjesën e arsyetimit ligjor të gjykatës ku ai integrohet me analizën ligjore, e bën atë një analizë të plotë, të gjithanshme dhe të kuptueshme për lexuesin. Në vendimet e themelit gjyqtarja i kushton rëndësi të veçantë analizës së integruar të provave në raport me katër elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, që lidhen me elementë të veçantë të anës objektive dhe subjektive të veprës

Në cilësinë e analizës, veçanërisht në çështjet e themelit dhe ato me objekt pushimin e procedimit penal, spikat lidhja në mënyrë të drejtpërdrejtë e faktit/fakteve të provuara, me elementët e figurës së veprës penale, të analizuara më parë në arsyetim, duke evidentuar qartë dhe në mënyrë të natyrshme lidhjen shkak-pasojë dhe konkluzionin e arritur për provueshmërinë e elementëve të figurës së veprës penale. Përgjithësisht gjyqtarja në vendimet e saj me përjashtim të ndonjë vendimi ndjek metodën “*IRAC* “*Issue, Rule, Application, Conclusion*” *pra* citim i ligjit; interpretim abstrakt i tij; zbatim i ligjit mbi faktin konkret dhe konkluzioni i gjykatës, që bën të evidentohet qartë lidhja shkak- pasojë.

Në lidhje me përmbajtjen gjithëpërfshirëse sa i përket marrjes në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në vendimet penale të analizuara, ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në pjesën përshkruese–arsyetuese të vendimit. Analiza e kërtimeve dhe pretendimeve të palëve, me karakter procedural apo material, merr gjithmonë përgjigje të argumentuar në arsyetimin e vendimit, në drejtim të mbështetjes në ligj ose prova të tyre.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, në vendimet gjyqësore të analizuara, analiza ligjore si në lidhje me aspekte procedurale të zhvillimit të gjyqimit, mënyrën e marrjes së provave apo vlerësimin e atyre, ashtu edhe në analizën ligjore të veprës penale ose objektit të kërkesës penale në shqyrtim, është një analizë e plotë, gjithëpërfshirëse dhe shteruese. Cilësia e analizës dhe argumentimin logjik përmbush në çdo rast jo vetëm standardet e procesit të rregullt ligjor, por pasurohet me interpretim të pavarur të ligjit si dhe qëndrime të praktikës gjyqësore, të cilat integrohen në mënyrë të natyrshme dhe në masën e duhur në arsyetim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” vlerësohet “ shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtarës për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar në total 162 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 320 çështje me afat standard minimal.

Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (gjithsej 39 çështje), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon

ketë afat ligjor (162 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 24% të çështjeve me afat ligjor jashtë këtij afati¹⁰.

Në tabelën nr. 9 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kundërvajtje penale” rezulton se janë gjykuar 2 (dy) çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor¹¹ (çështje me objekt: *Miratimin e urdhërit penal*¹²), të cilat janë gjykuar brenda afatit ligjor 10 ditë.

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, me objekt: “Kundërshtim i vendimit të Prokurorisë ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 21 çështje¹³, për të cilat ligji parashikon afat ligjor¹⁴, të cilat janë gjykuar brenda këtij afati.

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, me objekt: “Zëvendësim mase sigurimi personal” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 7 çështje¹⁵, për të cilat ligji parashikon afat ligjor¹⁶ 30 ditë, 4 nga të cilat janë gjykuar brenda afatit ligjor dhe 3 nga të cilat janë gjykuar jashtë këtij afati.

¹⁰ Nga çështjet e gjykuara jashtë afatit ligjor janë 89.74% çështjet e seancës paraprake me objekt: “Dërgim në gjyq”.

¹¹ Në tabelën nr. 9, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kundërvajtje penale” rezulton që çështjet për të cilat është parashikuar në ligj afat ligjor janë çështjet me numër rendor 9 dhe 17, pavarësisht përcaktimit të tyre në statistika, ku për çështjen është konsideruar si çështje me afat standard minimal (me objekt: *Miratimin e urdhërit penal*).

¹² Neni 406/b i Kodit të Procedurës Penale ndër të tjera parashikon se: “...1. Gjykata e shqyrton kërkesën pa praninë e palëve dhe vendos brenda dhjetë ditëve nga depozitimi i saj.... »

¹³ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në hetime paraprake” çështjet me objekt “Ankim ndaj vendimit të mosfillimit të vendimit të prokurorisë” janë çështjet me nr. Rendor 2-14 dhe 88-95.

¹⁴ Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale ndër të tjera parashikon se: « ...3. Ankimi shqyrtohet nga gjyqtari që gjykon kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake në dhomë këshillimi **brenda 30 ditëve nga depozitimi në sekretarinë e gjykatës të kopjes së akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit të procedimit.** Prokurori, jo më vonë se 15 ditë nga paraqitja e ankimit, i dërgon gjykatës një kopje të akteve që përmban fashikulli i vendimit të mosfillimit, si dhe ka të drejtë të paraqesë parashtrime me shkrim lidhur me bazueshmërinë e ankimit.... ». Pavarësisht se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë përcjellë të dhënat statistikore dhe në rubrikën «afat ligjor» është bërë shënimi « -« (minus) për çështjet me nr. Rendor 2-14, duke iu referuar si datë për fillimin e afatit 30 ditë, datës së regjistrimit, në fakt, në këto statistika është bërë përcaktimi se fashikulli i prokurorisë është depozituar në secilën datë reciprokisht, dhe duke marrë parasysh datën e depozitimit të fashikullit për secilën çështje, afati i shqyrtimit të secilës çështje rezulton brenda afatit 30 ditë, me përjashtim të çështjeve me nr. Rendor 6-9 dhe 11, ku data e depozitimit të fashikullit është data 01.03.2022 dhe data e shqyrtimit është data 04.04.2022, por dita e tridhjetë i bie ditë të shtunë (01.04.2022), për rrjedhojë këto çështje janë gjykuar brenda afatit. Neni 144 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se : « ...3. Afati i caktuar në ditë, kur ai mbaron në ditë pushimi ose feste, shtyhet deri në ditën pasardhëse të punës ose jofestive... » .

¹⁵ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në hetime paraprake” çështjet me objekt “Zëvendësim mase sigurimi personal”, janë çështjet me nr. Rendor 15-17 dhe 112-115.

¹⁶ Neni 260 i Kodit të Procedurës Penale ndër të tjera parashikon se: « ... 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj... ».

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt: “*Caktimi i masës së sigurimit personal dhe vleftësimi arresti, caktim mase sigurimi*” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 69 çështje¹⁷, për të cilat ligji parashikon afat ligjor¹⁸, të cilat janë gjykuar brenda këtij afati.

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt: “*Shuarje e masës së sigurimit*” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 14 çështje¹⁹, për të cilat ligji parashikon afat ligjor²⁰48 orë, 13 nga të cilat janë gjykuar brenda këtij afati, ndërsa 1 çështje është gjykuar jashtë afatit.

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale të hetimit paraprak*”, me objekt: “*Përrjashtim i trupit gjykues*” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 2 çështje²¹, për të cilat ligji parashikon afat ligjor²²48 orë, të cilat janë gjykuar brenda këtij afati.

Në tabelën nr. 11 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, me objekt: “*Dërgim në gjyq*”, rezulton se Gjyqtarja ka gjykuar 39 çështje²³ për të cilat ligji parashikon afat ligjor²⁴, nga të cilat 35 çështje janë gjykuar jashtë këtij afati²⁵30 ditë dhe 4 çështje janë gjykuar brenda këtij afati.

¹⁷ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale në hetime paraprake*” çështjet me objekt “*Caktim mase sigurimi*”, janë çështjet me nr. Rendor 18-87.

¹⁸ Nenet 244 e vijues i Kodit të Procedurës Penale parashikojnë afat 48 orë për shqyrtimin e kërkesës për caktim mase sigurimi personal.

¹⁹ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale në hetime paraprake*” çështjet me objekt “*Shuarje mase sigurimi*”, janë çështjet me nr. Rendor 98-111.

²⁰ Neni 261 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndër të tjera : « ...3. *Kërkesa për shuarjen e masës së sigurimit paraqitet së bashku me provat në gjykatën ku ndodhen aktet në momentin e paraqitjes së saj. Gjykata vendos brenda 48 orëve, pasi njofton palët... »*

²¹ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Kërkesa penale në hetime paraprake*” çështjet me objekt “*Përrjashtim i trupit gjykues*”, janë çështjet me nr. Rendor 96-97.

²² Neni 22 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndër të tjera : « ... 3. *Gjykata, pasi merr të dhënat e nevojshme, vendos për kërkesën e përrjashtimit brenda 48 orëve nga paraqitja e kërkesës.... »*

²³ Në tabelën nr. 11 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*Seanca paraprake*” çështjet me objekt “*Dërgim në gjyq*”, janë çështjet me nr. Rendor 75-113.

²⁴ Neni 332 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndër të tjera : « ... 3. *Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj... »*

²⁵ Në tabelën nr. 11, të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seanca paraprake*” ” rezulton që çështjet e shqyrtuara jashtë afatit ligjor janë me objekt “*dërgim në gjyq*” dhe janë me nr. rendor 75-109.

Në tabelën nr. 12 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”, me objekt: “Ekzekutim letërporosie” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 7 çështje²⁶ për të cilat ligji parashikon afat ligjor²⁷, të cilat janë gjykuar brenda afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja jep shpjegime për arsyet e kapërcimit të këtyre afateve, duke parashtruar se: *“Paraprakisht sqaroj se nga ana ime janë ndërmarrë të gjitha hapat e duhura për respektimin e afatit ligjor dhe mosrespektimi i tij në të gjitha rastet ka ardhur për shkaqe objektive të pavarura nga vullneti im, apo mënyra e organizimit të punës nga unë. Sigurisht që parësor kam konsideruar realizimin e një procesi të rregullt ligjor duke respektuar të drejtën e secilës palë për t’u dëgjuar, zhvillimin e një procesi kontradiktor dhe kryerjen e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Seancat gjyqësore janë shtyrë për arsye të përligjura, kryesisht për shkak të mosnjofitimit të palëve, mungesës apo ndryshimit të prokurorëve, kërkesave të palëve dhe ndonjëherë për shkak të mungesës time për shkaqe objektive. Caktimi i seancave të ardhshme është bërë në përputhje me natyrën e çështjeve duke ju dhënë prioritet kryesisht çështjeve me të mitur apo atyre me të paraburgosur.*

Në lidhje me çështjet me objekt «Dërgim në gjykim», sqaroj se për shkak të ndryshimeve që ka pësuar K.Pr.Penale në vitin 2021, ku legjislatori ka parashikuar që nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake duhet të ezaurohen të gjitha metodat e njoftimit sipas neneve 140 e vijues të K.Pr.Penale dhe në rast mosnjofitimi të të pandehurit gjykata disponon me vendim për pezullimin e çështjes për një vit në zbatim të nenit 352 të K.Pr.Penale, ka bërë që respektimi i afatit ligjor 30 ditor të jetë objektivisht i pamundur. Nëse njoftimi përmes shërbimit postar me «fletë-thirrje» nuk realizohet, duhet të kryhen kërkime në të 6 Komisariatet e qytetit të Tiranës dhe kthimi i përgjigjeve prej tyre shpesh zgjat disa muaj. Njëkohësisht sqaroj se në vitin 2022 ka pasur një sërë shkaqesh të konsiderueshme që kanë bërë të pamundur respektimin e afateve. Gjykata e Tiranës për shkak të vakancave të shumta është përballur me një volum të lartë çështjesh. Për një periudhë të gjatë më shumë se një mujore avokatët kanë bojkotuar proceset gjyqësore (muaj qershor-2022). Gjithashtu ndërprerja e shortit pas datës 22 Korrik deri në 1 shtator dhe 23 dhjetor deri 15 janar, për çështjet e regjistruara gjatë këtyre periudhave ka bërë që ky afat të ezaurohet i gjithi apo në pjesën më të madhe të tij në sekretari. I gjithë muaji Gusht është i planifikuar me lejet vjetore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në muajin Dhjetor janë festat e fundvitit, e në vijim deri në 15 Janar për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve i cili kryhet manualisht bënë të pamundur zhvillimin e gjykimeve gjatë kësaj periudhe.

Gjatë vitit 2022, kam pasur angazhime edhe në detyrën e anëtares së këshillit të gjykatës dhe disa herë edhe në atë të Zv. Kryetarit me kompetenca të Kryetarit²⁸. Në lidhje me

²⁶ Në tabelën nr. 12 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në fazën e ekzekutimit” çështjet me objekt “Ekzekutim letërporosie”, janë çështjet me nr. Rendor 33, 36, 38, 41, 42, 44, 45.

²⁷ Neni 506 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndër të tjera : « ... 3. Gjykata disponon ekzekutimin e letërporosisë me vendim brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës... »

²⁸ Lidhur me këtë fakt, në Programin MFiles, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka depozituar Autorizimet e Zv. Kryetarit me Nr. 3742/1 Prot., datë 31.05.2022, Nr. 3742/2 Prot., datë 20.07.2022, Nr. 3742/5 Prot., datë 02.08.2022, Nr. 3742/6 Prot., datë 07.11.2022, Nr. 3742/7 Prot., datë 25.11.2022, Nr. 3742/8 Prot., datë

shkaqet e mia personale sqaroj se nga data 22.01.2022 deri 31.01.2022 kam qenë me raport mjekësor « Covid-19 ». Nga data 02.03.2022 deri në datë 14.03.2022 kam qenë me leje vjetore të pakonsumuar. Nga data 26.03.2022-05.04.2022 me raport mjekësor «kujdes për djalin», nga data 25.04.2022 deri në datë 28.04.2022, kam qenë në trajnim jashtë vendit. Nga data 16.06.2022 deri 20.06.2022 raport mjekësor «kujdes për djalin». Nga data 23.07.2022 deri 28.07.2022 raport mjekësor «Covid» Nga data 19.12.2022 deri më datë 30.12.2022 kam qenë me leje vjetore të pakonsumuar, periudha këto gjatë të cilave kryesisht jam shortuar me çështje. Pavarësisht sa më sipër, kalimi i afateve nga ana ime ka qenë në përgjithësi disa ditë dhe ndonjëherë muaj, tejkalim i cili për sa më sipër relatuar nga ana ime, nuk duhet të merret në konsideratë nga ana Juaj. Pothuajse në të gjitha vendimet e caktimit të seancave gjyqësore apo në shtyrjet e tyre, në vendimin e caktimit apo në proces-verbale gjyqësore janë relatuar shkaqet e arsyes së caktimit të seancës në datën respektive.²⁹ Kam zgjedhur planifikimin e seancave efektive dhe jo të atyre fiktive e të perealizueshme, fakt i cili rezulton nga statistikat e mia nga të cilat rezulton që përgjithësisht çështjet janë zgjidhur brenda 1-3 seancave. Gjithashtu sqaroj se një numër çështjesh më kanë kaluar nga gjyqtar të tjerë. Çështjet me objekt «dërgim në gjykim», me Nr. Akti: 1481; 2808; 2735; 2478; 535 dhe 1352 (më kanë kaluar nga gjyqtar tjetër); 1767, janë zgjidhur me një seancë nga ana ime. Në urdhrin e caktimit të seancës janë parashtruar shkaqet e caktimit të seancës përtej afatit 30 ditor. Çështjet me nr. 1781 akti ; 944 akti ; 2767 akti ; 1624 akti ; 3312 akti ; 1799 akti ; 1820 akti ; 2795 akti ; 2780 akti, janë zgjidhur me dy seanca nga ana ime duke u relatuar shkaqet e caktimit të seancës së parë në atë datë, si dhe arsyet që përlligjin shtyrjen e seancës gjyqësore të shoqëruara me dokumentacion respektiv në disa raste. Në vijim, tek të gjitha çështjet e tjera, janë relatuar shkaqet e caktimit të seancës së parë në atë datë (kryesisht volumi i madh i dosjeve në gjykim dhe seancave të paraplanifikuara, gadishmëria me kërkesa në hetim, leje vjetore etj.), si dhe arsyet që përlligjin shtyrjen e seancave gjyqësore të bëra kryesisht për efekt të realizimit të njoftimeve apo mungesës së prokurorit. Referuar sa më sipër vlerësoj se ato duhet të konsiderohen brenda afatit nga ana Juaj.

Në lidhje me Kundërshtimet e vendimeve të mosfillimit, të gjitha janë gjykuar brenda afatit ligjor 30 ditor nga ardhja e fashikullit të prokurorit të gjykatë, ndaj ndonëse janë vlerësuar negativisht (pasur si referencë datën e regjistrimit të çështjes) ato duhet të vlerësohen pozitivisht duke u mbajtur në konsideratë momenti i ardhjes së fashikullit, moment nga i cili fillon afati i gjykatës sipa parashikimeve të K.Pr.Penale. Në lidhje me kërkesat 385, 406 dhe 978 me objekt « Zëvendësim mase sigurimi ».

30.12.2022, në të cilat Gjyqtarja {...} është autorizuar, në mungesë të kryetarit të ushtrisë kompetencat e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

²⁹ Në Programin MFiles, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka depozituar kopje të raporteve për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi për datat 21.01.2022-31.01.2022, 26.03.2022-05.04.2022, 16.06.2022-20.06.2022, 23.07.2022-28.07.2022 (total 29 ditë me raport mjekësor), si dhe akte të marrjes së lejes vjetore të pagueshme për 15 ditë pune për periudhën 01.08.2022-19.08.2022, 17.08.2022-30.08.2022, 02.03.2022-11.03.2022; po ashtu akte që lidhen me pjesëmarrjen e saj në një aktivitet jashtë vendit në Stockholm Suedi, për datat 25-27 Prill 2022 (High Level Case Law Seminar in Stockholm), organizuar nga Albanian –Swedish Juvenile Justice Programme.

1. Vendimi Nr.385 Regj Them, datë ardhje pranë gjyqtares 15.02.2022, data e vendimit 23.02.2022, është marrë në shqyrtim brenda afatit 5 ditor, por është shtyrë seanca për shkak të mungesës së prokurores dhe se dosja për caktimin e masës ndodhej në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Vendimi Nr.406 Regj Them, datë ardhje pranë gjyqtares 23.03.2022, data e vendimit 11.04.2022 për shkak se nga data 26.03.2022 deri me datë 05.04.2022 kam qenë me raport mjekësor.

3. Vendimi Nr.978 Regj Them, datë ardhje pranë gjyqtares 20.07.2022, data e vendimit 28.07.2022. Seanca gjyqësore e datës 25.07.2022, ora 10:15 nuk është zhvilluar për shkak se kam qenë me raport mjekësor nga data 23.07.2022-28.07.2022 dhe vendimi është marrë në datë 28.07.2023.

Sa më sipër vlerësoj se edhe këto çështje duhet të konsiderohen si të gjykuara brenda afateve ligjore nga ana ime.”

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë po ashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Nuk kam patur asnjë ankesë nga palët apo persona të interesuar lidhur me afatet e gjykimit gjatë proceseve të drejtuara nga gjyqtarja {...}. Ndonjë vonesë që mund të ketë rezultuar në afatet tërësore të gjykimit të çështjeve, është shkaktuar për shkaqe dhe rrethana objektive të pa varur nga sjellja e gjyqtares.”

Për të vlerësuar këtë tregues, sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli, këto të dhëna statistikore duhet të analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtares. Respektimi i këtyre afateve, jo gjithmonë është i varur nga gjyqtarja. Konkretisht, duke analizuar 39 çështjet, të cilat rezultojnë se janë gjykuar përtej afatit ligjor, sipas të dhënave nga raporti analitik evidentohet se;

Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale të hetimit paraprak”, me objekt: “Zëvendësim mase sigurimi personal” rezulton se, Gjyqtarja ka gjykuar 7 çështje³⁰, për të cilat ligji parashikon afat ligjor³¹, 4 nga të cilat janë gjykuar brenda afatit ligjor dhe 3 nga të cilat janë gjykuar jashtë këtij afati. Në lidhje me këto 3 çështje të identifikuar në statistika vetëm në çështjen me nr. rendorë 17, që i përket pikërisht vendimi nr.978 Regj Them, datë ardhje pranë gjyqtares 20.07.2022, data e vendimit 28.07.2022. Gjyqtarja ka rezultuar me raport mjekësor nga data 23.07.2022-28.07.2022 dhe vendimi është marrë në datë 28.07.2023 që do të thotë se kjo çështje duhet të konsiderohet si çështje gjykuar brenda afateve ligjore të parashikuar nga neni 260 i Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se: « ... 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj.

³⁰ Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Kërkesa penale në hetime paraprake” çështjet me objekt “Zëvendësim mase sigurimi personal”, janë çështjet me nr. Rendor 15-17 dhe 112-115.

³¹ Neni 260 i Kodit të Procedurës Penale ndër të tjera parashikon se: « ... 4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata ku ndodhen aktet, brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj... ».

Në tabelën nr. 11 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*seancë paraprake*”, me objekt: “*Dërgim në gjyq*”, rezulton se Gjyqtarja ka gjykuar 39 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor³², nga të cilat 35 çështje janë gjykuar jashtë këtij afati dhe 4 çështje janë gjykuar brenda këtij afati.

Në tabelën me nr. 11 në çështjen me nr. rendor 81 e reregjistruar me datë 30.08.2022 dhe përfunduar me date 05.10.2022 pra gjyqtares rezulton e shortuar me date 01.09.2022 dhe kohëzgjatja e gjykimit është 36 ditë me një tejkalim prej 6 ditësh por nëse marrim parasysh se që leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (*ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalendarike për gjyqtarët*) duke zbritur edhe 5 ditë të tjera atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar prej 30 ditësh.

Në tabelën me nr. 11 në çështjen me nr. rendor 99 e regjistruar me datë 28.01.2022 dhe përfunduar me date 04.04.2022, rezulton e shortuar pranë gjyqtares me date 02.04.2022 dhe kohëzgjatja e gjykimit është 66 ditë. Nëse marrim parasysh duke zbritur nga kjo periudhë, kohën që merr lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri të shortimi dhe dorëzimi të gjyqtarja edhe 32 dite të tjera atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar prej 30 ditësh me një tejkalim të papërfillshëm prej 4 ditësh .

Në tabelën me nr. 11 në çështjen me nr. rendor 102 e regjistruar me datë 23.03.2022 dhe përfunduar me date 09.05.2022, rezulton e shortuar pranë gjyqtares me datë 24.03.2022 dhe kohëzgjatja e gjykimit është 47 ditë. Nëse marrim parasysh duke zbritur nga kjo periudhë, dite ne te cilat gjyqtarja ka qenë me raporte mjekësorë (26.03.2022 - 05.04.2022; 25-27.04.2022) edhe 14 dite të tjera atëherë kjo çështje konsiderohet e përfunduar brenda afatit ligjor të parashikuar prej 30 ditësh me një tejkalim të papërfillshëm prej 3 ditësh. Po e njëjta përlllogaritje vlen dhe për çështjen me nr. rendor 101 dhe 109 me një kohëzgjatje gjykimi prej 49, 48 ditësh për secilën. Nëse nga kohëzgjatja e gjykimit zbritet periudha në të cilën gjyqtarja ka qenë me raporte mjekësorë përkatësisht 14 ditë gjatë periudhës së gjykimit të çështjes me nr. rendor 101 dhe 30 ditë (21.01.2022-31.01.2022 dhe 02-11.03.2022 dhe 26.03.2022-05.04.2022) gjatë gjykimit të çështjes me nr. rendor 109 si dhe ditët që merr lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri të shortimi dhe dorëzimi të gjyqtarja 4 ditë gjithsej në total 14 ditë dhe 34 ditë, atëherë rezulton se këto çështje konsiderohen të përfunduara brënda afatit ligjor të parashikuar prej 30 ditësh, me një tejkalim prej 5 ditësh çka mund të konsiderohet e papërfillshme për vetë ngarkesën e gjyqtares dhe natyrën e gjykimit. Ndërsa çështje me nr. rendor 109 gjykimi ka përfunduar brenda 14 ditëve.

Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se “*...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje, që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekteve të*

³² Neni 332 i Kodit të Procedurës Penale parashikon ndër të tjera : « ... 3. Gjykata vendos mbi kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të saj... »

tjera që lidhen me kushtet e punës, e cila mund të çojë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme deri në pikëzimin maksimal”.

Sa më sipër rezulton se pikërisht numri më i madh i çështjeve të gjykuara jashtë afati ligjorë janë ato me objekt “*Dërgim në gjyq*” për të cilat shqyrtimi i tyre brenda afatit ligjorë 30 ditore, bëhet objektivisht i pamundur për shkak të ndryshimeve ligjore konkretisht të K.Pr.Penale në vitin 2021, sipas të cilit gjyqtari i seancës paraprake duhet të ezaurojë të gjitha metodat e njoftimit sipas neneve 140 e vijues të K.Pr.Penale dhe në rast mosnjoftimi të pandehurit gjykata disponon me vendim për pezullimin e çështjes për 1 vit në zbatim të nenit 352 të K.Pr.Penale. Gjithashtu volumi i madh çështjeve të shqyrtuara nga gjyqtarja, raportet shëndetësore të gjyqtarës, muaji gusht është i planifikuar me lejet vjetore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, muaji dhjetor festat e fund vitit, e në vijim deri në 15 janar procesit të mbartjes së dosjeve i cili kryhet manualisht, bëjnë të pamundur zhvillimin e gjykimeve gjatë kësaj periudhe.

KONKLUZIONE:

Bazuar në sa më sipër, duke marrë parasysh, përjashtimin nga kjo periudhë, kohën që mund të ketë marrë lëvizja e dosjes nga momenti i regjistrimit deri të shortimi dhe dorëzimi të gjyqtarja, e cila nga të dhënat e tabelave statistikore rezulton për disa nga çështjet 1-7 ditë nga data e regjistrimit; kohën që i është dashur gjyqtarës për shtyrje të gjykimit për shkaqe të pavarura prej saj siç është njoftimi dhe respektimi i të drejtave të tjera të palëve; ngarkesën e gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit, nga ku rezulton se ajo ka gjykuar *disa herë më shumë* se numri i çështjeve sipas standardit minimal sasior të punës, të përcaktuar në vendimin nr. 261/2, dt. 14.04.2010, të KLD-së, dhe tejkalimin në disa prej tyre me një diferencën e vogël në kohë nga afati ligjor, vlerësoj se gjyqtarja duhet të vlerësohet me një shkallë më lartë se ajo që parashikon metodologjia për përqindjen që rezulton 19.7% që është 12 pikë, duke u pikëzuar maksimalisht për këtë tregues.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar përqindjes së çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor dhe shkallës së përgjegjësisë së gjyqtarës, vlerësohet se në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.*

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ka gjykuar në total 320 çështje për të cilat janë parashikuar afate orientuese për standardin minimal, prej të cilave 98 çështje jashtë afatit standard minimal kohor, ose 30% e tyre. Më konkretisht, konstatohet se:

- Në tabelën nr. 8 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Penale krime” rezultojnë se janë gjykuar 170 çështje³³, për të cilat në ligj nuk është parashikuar një afat i caktuar për përfundimin e tyre. Për këto çështje zbatohet afati standard minimal prej 9 dhe 12 (nëntë dhe dymbëdhjetë) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së). Nga këto 170 çështje rezulton se 15 çështje janë gjykuar jashtë afatit standard minimal³⁴, ndërsa 155 çështje është gjykuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 9 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Penale Kundërvajtje” rezultojnë se janë gjykuar 16 çështje³⁵, për të cilat në ligj nuk është parashikuar një afat i caktuar për përfundimin e tyre. Për këto çështje zbatohet afati standard minimal prej 4 (katër) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së). Nga këto 16 çështje rezulton se 3 çështje janë gjykuar jashtë afatit standard minimal³⁶, ndërsa 13 çështje janë gjykuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 10 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Hetime paraprake” me objekt: “Deklarim ikje”, “Sekuestro”, “Marrje kampioni biologjik” rezultojnë se janë gjykuar 3 çështje³⁷, për të cilat në ligj nuk është parashikuar një afat i caktuar për përfundimin e tyre. Për këto çështje zbatohet afati standard minimal prej 2 (dy) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së). Nga këto 3 çështje rezulton se të tria janë gjykuar brenda afatit standard minimal.
- Në tabelën nr. 11 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “Seanca paraprake” me objekt: “Pushim procedimi” rezultojnë se janë gjykuar 82 çështje, për të cilat në ligj nuk është parashikuar një afat i caktuar për përfundimin e tyre. Për këto çështje zbatohet afati standard minimal prej 2 (dy) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së). Nga këto 82 çështje rezulton se 54 çështje janë gjykuar jashtë afatit standard minimal³⁸, ndërsa 28 çështje është gjykuar brenda afatit standard minimal.

³³ Këtu përfshihen çështjet me nr.rendor 1-166 në tabelën nr. 8 dhe çështjet me nr. Rendor 5, 12,15, 16 në tabelën nr. 9, të cilat përbëjnë krime dhe jo kundërvajtje, si të tilla do të përfshihen në këtë kategori çështjes, pasi kanë për objekt veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 180/a, 109/b dhe 197 të Kodit Penal.

³⁴ Çështjet e gjykuara jashtë afatit standard minimal janë me nr. Rendor 1-14 (tabela nr. 8) dhe çështja me nr, rendor 12 (tabela nr.9). Këtu është bërë shënimi se për çështjet me nr. 1-12 kanë qenë të pezulluara. Neni 352 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “1. Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140 -142, të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, gjykata vendos pezullimin e tij dhe urdhëron policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit. Me kalimin e një viti nga data e pezullimit të gjykit për këtë shkak, si dhe në çdo moment kur ka informacione për vendndodhjen e të pandehurit, gjykata rifillon gjykimin, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit. »

³⁵ Këtu përjashtohen çështjet me nr. Rendor 9 dhe 14, të cilat kanë afat ligjor për shqyrtimin e tyre dhe çështjet me nr. 5, 12, 15, 16 të cilat u përlogaritën në tabelën nr. 8.

³⁶ Çështjet e gjykuara jashtë afatit standard minimal janë me nr. Rendor 2, 8, 10, 11, 19.

³⁷ Këtu përfshihen çështjet me nr. Rendor 1, 116, 117.

³⁸ Çështjet e gjykuara jashtë afatit standard minimal janë me nr. Rendor 1-54.

- Në tabelën nr. 12 të të dhënave statistikore, për çështjet e kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” rezultojnë se janë gjykuar 49 çështje, për të cilat në ligj nuk është parashikuar një afat i caktuar për përfundimin e tyre. Në këtë kontekst, për këto çështje zbatohet afati standard minimal prej 2 (dy) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së). Nga këto 49 çështje rezulton se 24 çështje janë gjykuar jashtë afatit standard minimal³⁹, ndërsa 25 çështje është gjykuar brenda afatit standard minimal .

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, gjyqtarja ka vlerësuar veten në shkallë shumë të lartë, duke parashtruar se: *Në ato çështje gjyqësore në të cilat është tejkaluar afati orientues, përveç arsyeve objektive të sqaruara në rubrikën e mësipërme, pezullimi i gjyqësorëve për 1 vit në çështjet penale të themelit është një tjetër shkak objektiv që ka ndikuar në mosrespektimin e afatit. Duhet theksuar fakti se në asnjë rast mosrespektimi i afatit nuk ka ndodhur për shkak të sjelljes sime si gjyqtare apo neglizhencës, apo për arsye jo objektive. Ai ka ndodhur për shkaqe të përligjura, të njohura si të tilla edhe nga GJEDNJ-ja, referuar standardeve që ka vendosur në jurisprudencën e saj për sa i përket gjykimit brenda një afati të arsyeshëm “*

Referuar Formularit të Vetëvlerësimit të gjyqtarit, rezulton se lidhur me treguesin “*plotësimi i standardeve minimale kohore*”, Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “*Gjyqtarja {...} manifeston aftësi shumë të mira organizative, duke ju dhënë prioritet çështjeve me të mitur si dhe çështjeve për të cilat ligji ka përcaktuar afate më të shkurtra procedurale. Ka përballuar një volum të madh pune duke gjykuar pothuajse gjithmonë brenda afateve ligjore.”*

Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore, për 96 çështjet e shqyrtuara jashtë standardit minimal kohor, rezulton se në disa raste vonesa në shqyrtim ka ardhur si pasojë e lejes vjetore të kryer nga gjyqtarja (*muaj gusht i vitit 2022, si dhe pezullimi i çështjes apo raporteve shëndetësorë të gjyqtarës*). Nëse në përllogaritjen e afatit të gjykimit nuk do të përfshihej periudhat e mësipërme, atëherë disa prej këtyre çështjeve do të kishin përfunduar brenda standardeve minimale kohor. Konkretisht:

- Nëse marrim në analizë çështjet e pasqyruara në tabelën 8 nga nr.rendor 1-14 dhe çështja me nr. rendor 12 (tabela nr.9). Në këtë tabelë është bërë shënimi se për çështjet me nr. 1-12 kanë qenë të pezulluara. Neni 352 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: “*1. Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140 -142, të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dënimin personalisht për gjykimin, gjykata vendos pezullimin e tij dhe urdhëron policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit. Me kalimin e një viti nga data e pezullimit të gjykimit për këtë shkak, si dhe në çdo moment kur ka informacione për vendndodhjen e të pandehurit, gjykata rifillon gjykimin, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit»*. Zbritja e periudhës se pezullimit prej 1 viti për secilën nga këto çështje bën që të konsiderohen çështje të shqyrtuara brenda afatit standard

³⁹ Çështjet e gjykuara jashtë afatit standard minimal janë me nr. Rendor 1-24.

minimal prej 12 muajsh të parashikuar vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të KLD-së Aneksi 1 pika 5 germa a.

- Gjithashtu nga verifikimi i çështjeve të pasqyruara në tabelën nr. 9 të të dhënave statistikore, çështja me nr. rendor 19 është shortuar pranë gjyqtares me datë 27.05.2022 dhe ka përfunduar me vendimin e datës 02.11.2022, që do të thotë se ka përfunduar brenda 159 ditëve. Nëse nga kjo periudhe zbritet muaji gusht që përkon me lejen vjetore të gjykatës atëherë shqyrtimi i kësaj çështje do kishte përfunduar brenda 124 ditëve, me një tejkallim të papërfillshëm prej katër ditësh duke e konsideruar brenda afatit standard minimal prej 4 (katër) muaj, sipas vendimit nr. 261/2 datë 14.04.2010 të ish KLD-së).
- Rezulton se çështjet me nr. rendor 9, 10, 13,21, 22, 41, 49 (tabela 11) i janë caktuar gjyqtares me short në datat respektive 02.11.2021, 12.11.2021, 17.11.2021; 02.12.2021; 11.03.2022; 06.07.2022; 04.04.2022 dhe kanë përfunduar në datat 120.01.2022; 18.01.2022; 19.01.2022; 10.02.2022; 11.05.2022; 06.06.2022 dhe 27.09.2022 duke hequr periudhën e lejes vjetore, festat e fund vitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë këto çështje do të kishin përfunduar për 64 ditë, 63 ditë, 57 ditë, 63 ditë, 61 ditë, 35 ditë, 63 ditë me një tejkallim të papërfillshëm nga 1- 4 ditësh duke e konsideruar brenda afatit standard minimal prej 2 (dy) muaj.
- Rezulton se çështjet me nr. rendor 6, 7, 9, 11, 15, 16, (tabela 12) i janë caktuar gjyqtares me short në datat respektive 12.11.2021, 07.02.2022 (date regjistrimi pasi s'kemi të dhëna), 24.02.2022 (datë regjistrimi pasi s'kemi të dhëna), 15.02.2022 (datë regjistrimi pasi s'kemi të dhëna) ,01.07.2022, 22.06.2022 dhe kanë përfunduar në datat 03.02.2022; 11.04.2022,23.05.2022, 22.04.2022,03.10.2022, 29.09.2022 duke hequr periudhën e gjate se cilës gjyqtarja ka qënë me raportë mjekësorë konkretisht gjithsej në total 13-24 ditë gjate periudhës se shqyrtimit të çështjeve këto çështje do të kishin përfunduar për 63 ditë, 43 ditë, 64 ditë, 53 ditë, 59 ditë, 64 ditë me një tejkallim të papërfillshëm nga 1-4 ditësh duke e konsideruar brenda afatit standard minimal prej 2 (dy) muaj.

Sa më sipër rezulton se raporti mes numri i çështjeve për të cilat është marre vendim në tejkallim të standardit minimal kohor 70, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (320 çështje), rezulton se gjyqtarja ka gjykuar jashtë standardit minimal kohor 21.8 % të çështjeve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme pikëzohet me 3 pikë. Por duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi deri në pikëzim maksimal duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtares. Gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total në gjithë periudhën e vlerësimit, nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022, gjithsej 482 çështje nga të cilat: Çështje penale krime 166; Çështje penale kundërvajtje 22; Çështje kërkesa penale të hetimit paraprak 117; Çështje penale seancë paraprake 121; Çështje kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënive juridiksionale me jashtë 56. Gjithashtu duhet marrë parasysh

fakti se nga numri total i çështjeve 309 janë çështje me palë kundërshtare ose 64.1 % të totalit të çështjeve.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit si: raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezultojnë në masën 21.8 % ; shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjyqimit sikurse është ngarkesa e lartë pasi rezultojnë se gjyqtarja ka përfunduar gjatë gjithë vitit 2022 gjithsej 482 çështje, nga të cilat 309 çështje themeli, që përkon me 3 fishin e standardit orientues sasior; ecurisë procedurale të çështjeve, për respektimin e procesit të rregullt ligjor, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 21.8 % të çështjeve jashtë standardit minimal ka ardhur përgjithësisht për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarës, sikundër është treguesi sasior i punës së saj (482 çështje të përfunduara me vendim).*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka gjykuar në total 170 çështje të kategorisë “krime”, 16 çështje të kategorisë “kundravajtje”, 3 çështje të kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, 82 çështje të kategorisë “seancë paraprake”, si dhe 49 çështje të kategorisë “kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë”.

Referuar të dhënave statistikore, rezultojnë se gjyqtari subjekt vlerësimi ka gjykuar në cilësinë e raportit 320 çështje (standard minimal kohor), nga të cilat: 170 çështje të kategorisë “krime”, 16 çështje të kategorisë “kundravajtje”, 3 çështje të kategorisë “hetime paraprake”, 82 çështje të kategorisë “seancë paraprake”, si dhe 49 çështje të kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit”.

Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “penale krime”, koha mesatare rezultojnë të jetë 71.2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati standard minimal kohor i miratuar prej 9 apo 12 muaj.

Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “penale kundërvajtje”, koha mesatare rezultojnë të jetë 103 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.

Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “hetime paraprake”, koha mesatare rezultojnë

të jetë 4 ditë, pra më e shkurtër se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.

Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*seanca paraprake*”, koha mesatare rezulton të jetë 79.5 ditë, pra më e gjatë se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.

Në lidhje me çështjet tek kategoria e çështjeve “*në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton të jetë 69.6 ditë, pra më e gjatë se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj.

Duke u bazuar vetëm në analizën matematikore të të dhënave, rezulton se: çështjet tek kategoria e çështjeve “*Në fazën e ekzekutimit dhe marrëdhënie juridiksionale me jashtë*”, koha mesatare rezulton 69.6 ditë referuar raportit analitik pasi duke zbritur pikërisht periudhat gjate të secilës gjyqtarja ka qenë me raporte mjekësorë (*konkretisht datat 02.03.2022 -11.03.2022 dhe nga data 26.03.2022-05.04.2022*) kjo mesatare zbret në 67 ditë që rezulton më e gjatë se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj. Por duke qenë se kemi tejkalim me vetëm prej 7 ditësh *afati standard i gjykimit për këtë kategori çështjesh do të konsiderohet shkurtër* se afati standard minimal kohor i miratuar prej 2 (dy) muaj ose 60 ditësh.

Sa më sipër rezulton që vetëm një nga 5 kategoritë e çështjeve te sipërcituara (shumicën) koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Në formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja ka evidentuar se “*E vlerësoj shumë të lartë aftësinë time për të përfunduar çështje në afat, sipas kategorisë përkatëse në raport me standardet minimale të kërkuara për çdo kategori. Jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e parashikuara si standarde minimale kohore, sipas kategorive, por gjithmonë duke u kujdesur që kjo të mos cenojë të drejtat e palëve në proces, kontradiktoritetit, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, cilësinë e gjykimit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor. Në lidhje me këtë kriter vlerësoj se duke iu referuar të dhënave statistikore rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve me përjashtim të kategorive të çështjeve “Dërgim në gjykim”. Duke parashtruar sa më sipër vlerësoj të theksoj se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe të arsyeshme dhe në funksion të zgjidhjes në themel të tyre dhe për këtë tregues duhet të kem një vlerësim maksimal. Lidhur me këtë tregues “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje”, Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Mendoj që nga ana e gjyqtarës është bërë më e mira e mundshme në administrimin e kohës gjyqësore, duke vlerësuar e duke patur parasysh kushtet dhe rrethanat konkrete; Ngarkesat në gjykime, si dhe vështirësitë objektive që shfaqen gjatë ecurisë së gjykimeve, të cilat padyshim ndikojnë në afatet ligjore.”*”

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e

gjqtarit⁴⁰. Referuar metodologjisë, duke qenë se nga 5 kategori çështjesh, vetëm 1 prej tyre koha mesatare tejkalon standardin minimal kohor, gjyqtarja duhej të pikëzohej me 4 pikë. Por vlerësuesi merr parasysh në pikëzimit situatën konkrete, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 2 muaj vetëm për kategorinë e çështjeve “*seanca paraprake*”. Duke analizuar këtë kategori çështjesh rezulton se nga 10 çështje, afati standard është tejkalar në 3 prej tyre, konkretisht çështjet me numër rendor 3, 4 dhe 5 të tabelës me të dhëna statistikore. Në nenin 352 të K.Pr.Penale parashikohet se : “...Kur i pandehuri në gjendje të lirë, me gjithë kërkimet, sipas neneve 140 -142, të këtij Kodi, nuk paraqitet në seancë dhe rezulton se nuk ka marrë dijeni personalisht për gjykimin, gjykata vendos pezullimin e tij dhe urdhëron policinë gjyqësore të vazhdojë kërkimin e të pandehurit. Me kalimin e një viti nga data e pezullimit të gjykimit për këtë shkak, si dhe në çdo moment kur ka informacione për vendndodhjen e të pandehurit, gjykata rifillon gjykimin, duke urdhëruar përsëritjen e njoftimit. Kur edhe pas kërkimeve të kryera rishtazi i pandehuri nuk gjendet, gjykata deklaron mungesën. Në këtë rast gjykimi zhvillohet në praninë e mbrojtësit....”

Sa më sipër vlerësoj se niveli i pikëzimit të gjyqtarës për këtë tregues duhet të jetë më i lartë se 4, në nivelin maksimal.

KONKLUZIONE:

Mbështetur në të njëjtën analizë si më sipër rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër se standardi minimal kohor për secilën kategori. Për këtë arsye, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është e lartë dhe duhet të pikëzohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, rezulton më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve, prandaj në lidhje me këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.*

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se rezulton se rendimenti i subjektit të vlerësimit është si më poshtë vijon:

⁴⁰Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se :”... Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal.”.

- Për çështje të kategorisë “penale krime” rendimenti është 92.89 %;
- Për çështje të kategorisë “penale kundravajtje” rendimenti është 66.66 %;
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale gjatë hetimit paraprak” rendimenti është 89.31 %;
- Për çështje të kategorisë “seancë paraprake” rendimenti është 88.32 %;
- Për çështje të kategorisë “kërkesa penale në fazën e ekzekutimit dhe marëdhënieve juridiksionale me jashtë” rendimenti është 91.8 %;

Në total duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve gjyqësore të përfunduara nga gjyqtari pavarësisht kohës së caktimit të tyre (539) me numrin e çështjeve gjyqësore që ka shqyrtuar brenda vitit kalendarik (482), rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore në total është 89.42%.

Rezulton se në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja, ka parashtuar se ; *“Për këtë rubrikë përsëri vlerësoj se kam aftësi shumë të larta, pasi jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e gjykimit dhe kushtoj çështjeve kohën e duhur, pavarësisht se kompleksitetit tyre, ngarkesa e gjykatës, modalitetet, apo problemet me njoftimet, sjellja e palëve, apo arsye objektive të ndryshme mund të kenë çuar në zgjatjen e afatit. Mendoj që kam aftësi shumë të lartë në përfundimin në kohë të çështjeve gjyqësore. Njëkohësisht risqaroj se në vitin 2022 ka pasur një sërë shkaqesh të konsiderueshme që kanë bërë të pamundur respektimin e afateve. Gjykata e Tiranës për shkak të vakancave të shumta është përballur me një volum të lartë çështjesh. Për një periudhë të gjatë më shumë se një mujore avokatët kanë bojkotuar proceset gjyqësore (muaj qershor-2022). Gjithashtu ndërprerja e shortit pas datës 22 Korrik deri në 1 shtator dhe 23 dhjetor deri 15 janar, për çështjet e regjistruara gjatë këtyre periudhave ka bërë që i gjithë afati apo një pjesë e madhe të tij të ezaurohet i gjithi në sekretari. I gjithë muaji Gusht është i planifikuar me lejet vjetore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Në muajin Dhjetor janë festat e fundvitit, e në vijim deri në 15 Janar për shkak të procesit të mbartjes së dosjeve i cili kryhet manualisht bënë të pamundur zhvillimin e gjykimeve gjatë kësaj periudhe. Gjatë vitit 2022 kam pasur angazhime edhe në detyrën e anëtares së këshillit të gjykatës dhe disa herë edhe në atë të Zv. Kryetarit me kompetenca të Kryetarit. Në lidhje me shkaqet e mija personale sqaroj se nga data 22.01.2022 deri 31.01.2022 kam qenë me raport mjekësor « Covid-19 ». Nga data 02.03.2022 deri në datë 14.03.2022 kam qenë me leje vjetore të pakonsumuar. Nga data 26.03.2022-05.04.2022 me raport mjekësor «kujdes për djalin», nga data 25.04.2022 deri në datë 28.04.2022, kam qenë në trajnim jashtë vëndit. Nga data 16.06.2022 deri 20.06.2022 raport mjekësor «kujdes për djalin». Nga data 23.07.2022 deri 28.07.2022 raport mjekësor «Covid» Nga data 19.12.2022 deri më datë 30.12.2022 kam qenë me leje vjetore të pakonsumuar, periudha këto gjatë të cilave kryesisht jam shortuar me çështje dhe afati duhet të konsiderohet i pezulluar nga ana Juaj.⁴¹ Pavarësisht sa më sipër, kalimi i afateve ka qenë në përgjithësi disa ditë dhe*

⁴¹ Lidhur me këtë fakt, në Programin MFiles, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka depozituar Autorizimet e Zv. Kryetarit me Nr. 3742/1 Prot., datë 31.05.2022, Nr. 3742/2 Prot., datë 20.07.2022, Nr. 3742/5 Prot., datë 02.08.2022, Nr. 3742/6 Prot., datë 07.11.2022, Nr. 3742/7 Prot., datë 25.11.2022, Nr. 3742/8 Prot., datë 30.12.2022, në të cilat Gjyqtarja {...} është autorizuar, në mungesë të kryetarit të ushtrojë kompetencat e

ndonjëherë muaj, tejkalim i cili për sa më sipër relatuar nga ana ime, nuk duhet të merret në konsideratë nga ana Juaj. Pothuajse në të gjitha vendimet e caktimit të seancave gjyqësore apo në shtyrjet e tyre, në vendimin e caktimit apo në proces-verbale gjyqësore janë relatuar shkaqet e arsyes së caktimit të seancës në datën respektive. Kam zgjedhur planifikimin e seancave efektive dhe jo të atyre fiktive e të perealizueshme fakt i cili rezulton nga statistikat e mija nga të cilat rezulton që përgjithësisht çështjet janë zgjidhur brenda 1-3 seancave.

Pavarësisht se më sipër, vlerësoj se numri i çështjeve gjyqësore të përfunduara nga ana ime përgjatë periudhës së vlerësimit përfaqëson një numër të konsiderueshëm çështjesh të përfunduara për një vit kalendarik, referuar mesatares së ngarkesës së punës së gjyqtarit të miratuar, duke treguar një efikasitet të lartë të punës së gjyqtarit. Në këto kushte, vlerësoj se ky fakt duhet të merret në konsideratë nga Këshilli, për efekt të pikëzimit në lidhje me efikasitetin në punë, e cila në vlerësimin tim, duhet të jetë në nivelin maksimal.”

Në përfundim në lidhje me këtë tregues rezulton se subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” në shkallë shumë të lartë.

Referuar Formularit të Vetëvlerësimit të gjyqtarës, rezulton se lidhur me treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore”, Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Gjyqtarja ka përballuar me shumë sukses një ngarkesë pune të konsiderueshme, duke përfunduar një numër të lartë çështjesh në harkun e një viti, në raport me ngarkesën totale të punës/ numrit të çështjeve të cilat i janë caktuar për të gjykuar gjatë këtyre viteve.”

Gjyqtarja ka përfunduar këtë vit kalendarik në total në gjithë periudhën e vlerësimit, nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022, gjithsej 482 çështje nga të cilat: Çështje penale krime 166; Çështje penale kundërvajtje 22; Çështje kërkesa penale të hetimit paraprak 117; Çështje penale seancë paraprake 121; Çështje kërkesa penale gjatë fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë 56. Gjithashtu duhet marrë parasysh fakti se nga numri total i çështjeve 309 janë çështje me palë kundërshtare ose 64.1 % të totalit të çështjeve.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit viti

Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në Programin MFiles, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka depozituar kopje të raporteve për paaftësi të përkohshme në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi për datat 21.01.2022-31.01.2022, 26.03.2022-05.04.2022, 16.06.2022-20.06.2022, 23.07.2022-28.07.2022 (total 29 ditë me raport mjekësor), si dhe akte të marrjes së lejes vjetore të pagueshme për 15 ditë pune për periudhën 01.08.2022-19.08.2022, 17.08.2022-30.08.2022, 02.03.2022-11.03.2022; po ashtu akte që lidhen me pjesëmarrjen e saj në një aktivitet jashtë vendit në Stockholm Suedi, për datat 25-27 Prill 2022 (High Level Case Law Seminar in Stockholm), organizuar nga Albanian –Swedish Juvenile Justice Programme.

kalendari më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli. Në këtë këndvështrim gjyqtarja {...} ka shqyrtuar brenda një viti kalendarik rreth 3 fishin e minimumit të parashikuar nga Aneksi 1 pika 3 germa a në të cilin parashikohet se; “ *Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës penale brenda një viti kalendarik duhet të shqyrtojë jo më pak se 100 çështje penale (krime kundravajtje)*” ndërkohë sipas të dhënave statistikore të analizuara më sipër rezulton se gjyqtarja ka përfunduar 309 çështje me palë kundërshtare çka e bën gjyqtaren të pikëzohet në maksimumin e pikëve të parashikuara nga metodologjia për këtë kriter.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 10 pikë, pasi gjyqtarja ka shqyrtuar më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli pasi gjyqtarjaka shqyrtuar brenda një viti kalendarik rreth 3 fishin e minimumit të parashikuar nga Aneksi 1 pika 3 germa a.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor nga ana e gjyqtares, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural, për të gjitha kategorive të çështjeve, e konkretisht;

- (i) Për çështje të kategorisë “*krime*” koha mesatare e arsytimit është 13.2 ditë, pra dukshëm më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (ii) Për çështje të kategorisë “*kundravajtje penale*” koha mesatare e arsytimit është 17 ditë, pra më e shkurtër se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (iii) Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake*”, me objekt “*Ankim ndaj vendimit të mosfillimit*”, (neni 291 i K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është **5.5 ditë**, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (iv) Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake*”, me objekt “*Deklarim i ikjes*”, (neni 247 i K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, koha mesatare e arsytimit është **14 ditë**, pra më e shkurtër se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (v) Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake*”, me objekt

- “Vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi (për efekt të së drejtës së ankimit)”*, (neni 249 të K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **2.9** ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 249 i Kodit të Procedurës Penale.
- (vi) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake”*, me objekt *“Zëvendësim mase sigurimi, shuarje mase sigurimi”*, (nenet 248, 249, 260, 261 të K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **5.38** ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 248 i Kodit të Procedurës Penale.
- (vii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake”*, me objekt *“Marrje kampioni biologjik”*, (neni 201/a i K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **0** ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (viii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake”*, me objekt *“Sekuestro”*, (Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”), për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **0** ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i Kodit të Procedurës Penale.
- (ix) Për çështje të kategorisë *“seancë paraprake – dërgim në gjyq”* për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **10.5** ditë, **pra më e gjatë** afati procedural i posaçëm 10 ditë i parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 332/dh i Kodit të Procedurës Penale.
- (x) Për çështje të kategorisë *“seancë paraprake – kërkesë për pushim procedimi dhe kundërshtim vendim pushimi”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 18.58 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382/2 i Kodit të Procedurës Penale.
- (xi) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”*, me objekt *“Shtyrjen e ekzekutimit të vendimit,”* (neni 476/3 i K.Pr.Penale) për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 11.5 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural prej 5 ditë i parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 476 i Kodit të Procedurës Penale.
- (xii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”* me objekt: *Miratim ekstradimi, Kërkesë për ekstradim*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit (Ligji nr. 10193, datë 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale), koha mesatare e arsyetimit është **5 ditë**, **pra më e gjatë** se afati procedural **prej 3 ditëve**, i parashikuar nga paragrafi i tretë i nenit 39 të Ligjit nr.10193, datë 03.12.2009.
- (xiii) Për çështje të kategorisë *“kërkesa penale të fazës së ekzekutimit”* për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 11.9 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë

i parashikuar nga neni 382/2 i Kodit të Procedurës Penale.

(xiv) Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit*”, me objekt “*Rivendosje në afat,*” (neni 420/1 i K.Pr.Penale) për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 12.3 ditë, pra *më e gjatë* se afati procedural prej 5 ditë, për efekt të së drejtës së ankimit, i parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 420/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Referuar formularit të integruar të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka parashtruar se : “*Vlerësoj se kam aftësi shumë të lartë të arsyetimit në kohë të vendimit. Pothuajse në të gjitha çështjet e mbyllura dhe arsyetuara prej meje gjatë periudhës së rivlerësimit vendimet janë arsyetuar për një afat më të shkurtër ose të barabartë me afatin procedural. Sqaroj gjithashtu, se përsa i përket ndonjë rasti sporadik mosrespektimi ka ardhur për shkaqe objektive, leje, raport apo ngarkesa ime shumë e lartë në punë.*”

Gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “*Referuar statistikave rezulton se të gjitha dosjet e përfunduara nga gjyqtarja janë arsyetuar brenda afatit të përcaktuar në ligj.*”

Nga analiza e të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se për tre nga kategoritë e mësipërme konkretisht: Çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së hetimeve paraprake*”, me objekt “*Zëvendësim mase sigurimi, shuarje mase sigurimi*”, (nenet 248, 249, 260, 261 të K.Pr.Penale), për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **5.38** ditë, *pra më e gjatë* se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 248 i Kodit të Procedurës Penale , për çështje të kategorisë “*seancë paraprake – dërgim në gjyq*” për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është **10.5** ditë, pra *më e gjatë* afati procedural i posaçëm 10 ditë i parashikuar nga paragrafi i dytë i nenit 332/dh i Kodit të Procedurës Penale.

Për të dy këto kategori, rezulton se ky tejkalim është me 0.38 dhe 0.5 ditë tejkalim ky i papërfillshëm për tu konsideruar si kohë mesatare e arsyetimit *më e gjatë* se afati procedural i parashikuar nga ligji.

Gjithashtu dhe në lidhje me çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit*”, me objekt “*Rivendosje në afat,*” (neni 420/1 i K.Pr.Penale) për të cilat ligji procedural ka parashikuar afat për arsyetimin e vendimit, koha mesatare e arsyetimit është 12.3 ditë, pra *më e gjatë* se afati procedural prej 5 ditë, për efekt të së drejtës së ankimit, i parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 420/1 i Kodit të Procedurës Penale. Duke marrë parasysh se gjyqtarja në formularin e vetëvlerësimit është shprehur, se ka qënë gjithmonë e kujdesshme në arsyetimin në kohë të vendimeve dhe raste të veçanta kanë bërë që afati të tejkalojë, kjo ardhur për shkaqe objektive, raport mjekësorë. Konkretisht nëse zbresim ditët në të cilat gjyqtarja ka qene me raport mjekësore data 02.03.2022-11.03.2022 si dhe datat 16.06.2022-20.06.2022 për çështjet me nr. rendor 49 dhe 58 (*tabela 12*) koha e arsyetimit të vendimit zbret për secilën në 3 ditë dhe 10 ditë .

Sa me sipër kjo mesatare zbret në **6.5 ditë** një tejkalim prej **1.5** ditësh, që duke marrë

parasysh ngarkesën e gjyqtares shqyrtimi i një numri të madh çështjeve konsiderohet si një tejkalim i papërfillshëm.

KONKLUZIONE:

Për sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të veçantë që të respektojë afatet dhe vetëm në 2 nga 14 kategoritë rezulton që ky afat të jetë tejkaluar. Duke patur parasysh numrin e madh të çështjeve të shqyrtuara nga ana e gjyqtares 1030 çështje për gjithë periudhën e vlerësimit, vlerësoj se gjyqtarja ka treguar shkallë të lartë të aftësisë për këtë tregues dhe duhet të vlerësohet maksimalisht.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares për këtë tregues duhet të pikëzohet me 15 pikë.*

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit, konkretisht të dhënave statistikore⁴², rezulton se nuk është gjëndëruar numri i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe në mungesë të saj do t'i referohemi në total 6 (gjashtë) çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar është **2.2 seanca gjyqësore** (duke përjashtuar seancat paraprake kur çështja është zgjidhur në apel dhe çështjen pa palë kundërshtare⁴³). Po ti referohemi numrit mesatar të seancave sipas **kategorive** të çështjeve rezulton se numri mesatar për kategorinë "seancë paraprake" është 1.6 seanca, ndërsa për kategorinë "penale krime" është 3 seancë.

Gjyqtarja ne formularin e vetëvlerësimit ka parashtruar se : "*Referuar orientimeve të dhëna në shpjegimin e mësipërm, vlerësoj se aftësia e planifikimit të seancave gjyqësore dhe shmangia e seancave jo produktive, është e lartë, referuar edhe afateve të përfundimit të*

⁴² Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë tregues është parashikuar: "Treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikave mundësohen në rrugë elektronike. **Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.**" Duke iu referuar statistikave, të përcjella nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, ndaj do të merret si burim vlerësimi për këtë tregues çështjet e përzgjedhura me short.

⁴³ Sipas metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, në lidhje me këtë treguesin e numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, është parashikuar: "*Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, **duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse.***"

gjkimit të analizuara më sipër, si dhe përqindjes shumë të vogël të çështjeve gjyqësore të gjykuara jashtë afatit ligjor apo atij orientues. Në shumicën e çështjeve gjyqësore të shqyrtuara, janë planifikuar 1-3 seanca gjyqësore (çështje penale me gjykim të shkurtuar; kërkesa penale në fazën e ekzekutimit, kërkesa penale gjatë hetimeve paraprake; kërkesa penale në seancë paraprake, kërkesë për pushim çështje ose kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, etj). Nga ana tjetër, në çështjet gjyqësore për të cilat janë planifikuar më shumë se tre seanca, duhet theksuar se shkak kryesor ka qene mosnjoftimi efektiv i palëve për shkak të pasaktësisë së adresave, kërkesa për shtyrje të paraqitura nga palët të cilat kanë rezultuar të justifikuar, vonesave të krijuara nga shërbimi postar apo shërbimet e policisë gjyqësore etj. Në këtë rast të fundit, Gjykata gjithmonë i është drejtuar me shkresë Drejtorisë Vendore të Policisë, ku i është tërhequr vëmendje në lidhje me vonesat e dërgimit të akteve të njoftimit nga shërbimet e policisë gjyqësore. Nga ana tjetër, përgjithësisht tejkalimi i numrit minimal të seancave gjyqësore, është diktuar edhe nga nevoja e ndjekjes së të gjitha hapave të njoftimit sipas parashikimit të dispozitave procedurale, të cilat qëndrojnë edhe në themel të respektimit të procesit të rregullt gjyqësor. Gjithashtu, si shkak i tejkalimit të numrit minimal të seancave në gjykimet penale ka shërbyer edhe ndjekja e ritit të gjykimit të zakonshëm, ku është proceduar me pyetjen e dëshmitarëve. Në të gjitha rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, kam marrë masa efektive që të shmangë dështimin e seancës së rradhës, duke urdhëruar të kryhen njoftimet në një kohë sa më të shpejtë, duke dërguar shkresa në institucionet përgjegjëse, duke marrë masa administrative për mbrojtësit apo ekspertët që kanë shtyrë seancat pa shkaqe të arsyeshme etj. Kam studiuar çështjet në një kohë sa më të shkurtër, duke punuar edhe jashtë orarit zyrtar. Kam kryer veprime të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive si: kalendari seancave, mbikëqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit dhe përsëritja e tyre përpara seancës në rast të mosrealizimit; marrja e masave për të siguruar njoftime të rregullta për seancat pasardhëse duke bërë shënimet përkatëse në fletë-thirrje apo njoftim paralelisht me mënyra të tjera si telefon/adresë elektronike etj.”

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivel Shumë të lartë.

Gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Referuar statistikave rezulton se të gjitha dosjet janë vënë në lëvizje nga gjyqtarja brenda afatit të përcaktuar në ligj dhe planifikimi i seancave gjyqësore është kryer ne përputhje me volumin dhe kompleksitetin e çështjeve që ka patur në gjykim.”

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja në çdo rast ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet për këtë arsye gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, sepse ajo ka treguar shkallë të lartë aftësie për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive dhe përfundimin e gjykimit brenda afateve orientuese.

KONKLUZIONE:

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, numri mesatar i seancave gjyqësore për të dy kategoritë është 2.3 dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj gjyqtarja vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive” vlerësoj se aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është shumë e lartë, dhe duhet të pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se përgjithësisht gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit.

Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjyqtarja ka vënë dosjen në lëvizje brenda brenda 5 ditëve, sikundër parashikohet në nenin 332/1 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, në nenet 333/1 dhe 406/dh të K.Pr.Penale, për çështjet e kategorisë penale themeli ⁴⁴).

Ajo çfarë konstatohet është se në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja ka treguar kujdes në marrjen e masave për njoftimin e palëve, me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë, në çështjet penale (nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale) apo sipas rritit të gjykimit të zhvilluar (nenet 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar), ose sipas rritit të gjykimeve të seancave paraprake (neni 332/c i K.Pr.Penale).

Gjatë gjykimit gjyqtarja tregon kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, të mbrojtësve, relativitetin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqet e mosparaqitjes së palëve ose të pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit shpalljen e trupit gjykues, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës

⁴⁴ Në secillen dosje gjyqtarja në urdherin për caktimin e seancës gjyqësore ka saktësuar datën e ardhjes së dosjes pranë gjyqtarës.

zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre dhe arsyet e vendimmarrjes.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, nuk janë mbajtur me regjistrim audio, për shkak të numrit të pamjaftueshme të sallave në dispozicion për zhvillimin e seancave gjyqësore me regjistrim audio pavarësisht kësaj, procesverbalet janë dokumentuar me shkrim nga sekretarja gjyqësore⁴⁵ të nënshkruara nga gjyqtarja dhe shënohet në çdo rast ora e fillimit dhe mbarimit të seancës gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjykimit në kohë, me efikasitet, duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse dhe duke shmangur seancat joproduktive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues vlerësoj se është “Shumë e lartë”, dhe duhet pikëzuar me 20 pikë.

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se nga ana e gjyqtarës renditja e akteve të dosjes gjyqësore është në atë mënyrë që e bën dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme. Procesverbali rezulton të jetë i përpiluar rregullisht, përmban datën, orën, vendin e mbajtjes së tyre dhe çdo zhvillim procedural në seancë, ku janë dokumentuar çdo vendim i ndërmjetëm dhe ai përfundimtar, i shoqëruar me bazën ligjore dhe arsyetimin përkatës. Rezultojnë se janë respektuar parashikimet e nenit 115 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu konstatohet se aktet në dosje dhe dokumentacioni përkatës i përket çështjes konkrete.

Mënyra e renditjes së akteve në dosje e bën atë lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë.

⁴⁵ Përveç çështjeve të cilat shqyrtohen në dhomë këshillimi për të cilat nuk është mbajtur procesverbal për shkak të rritit të shqyrtimi konkretisht dosja me nr. 1292 Reegjistri datë 13.06.2022 dhe ate vendimi 08.07.2022.

KONKLUZIONE:

Në tërësi dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara, të renditura në mënyrë logjike dhe orientojnë drejt lexuesin për vendndodhje e tyre duke krijuar mundësi për tu shfrytëzuar me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës për këtë tregues është “shumë e lartë” pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short ndodhen të gjitha aktet dhe dokumentacioni i administruar gjatë gjykimit, nga momenti i caktimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit të saj. Në çdo dosje administrohen aktet shkresore të paraqitura nga palët ndërgjyqëse (*kërkesa penale, provat, kërkesat dhe konkluzionet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur me shkrim*), aktet e hartuara nga gjykata (*aktet e shortit, vendimi për caktimin e çështjes gjyqësore, komunikimet shkresore me të tretët, njoftimet, procesverbalet seancave gjyqësore dhe vendimet gjyqësore përfundimtare*).

Në dosjet penale, nuk rezulton të jetë administruar kopje e “Letrës së të drejtave” e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a46, 5847, 140 pg 148 dhe 13749 i K.Pr.P. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.P subjekteve i janë garantuar duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mos administrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore dhe mospasqyrimi në këtë të fundit i komunikimit të letrës së të drejtave, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

KONKLUZIONE:

⁴⁶ Në nenin 34/a, pika 2 dhe 3 të K.Pr.P parashikohet se :” 2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar. 3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”

⁴⁷ Neni 58 pika 2 i K.Pr.P parashikon se :” 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre.”

⁴⁸ Neni 140, pg 1 i K.Pr.P parashikon se : « 1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi.... »

⁴⁹ Neni 137, pg 1 i K.Pr.P parashikon se :” 1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëlloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë....”

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë aftësie mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të “letrës të të drejtave” e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues është “mbi mesatare”, duke pikëzuar me 8 pikë.

Nivelin i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Me shkresën me Nr.2107/1 prot., datë 04.07.2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarit {...}. Pas verifikimeve përkatëse ka rezultuar se për Gjyqtaren, {...} nuk është depozituar asnjë ankesë.

Sa i përket masave disiplinore të dhëna ndaj gjyqtares rezulton se nuk është dhënë asnjë masë disiplinore për gjyqtarin {...}, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Gjyqtarja subjekt vlerësimi dhe Zv. Kryetari i Gjykatës e kanë vlerësuar treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “shumë e lartë” dhe pikezohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtarit

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për gjyqtaren {...} nuk rezulton të jenë paraqitur ankesa pranë ILD-së.

Gjithashtu, nuk rezulton që ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit të jetë dhënë apo zbatuar ndonjë masë disiplinore.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ-së për gjyqtares {...}, përcjellë pranë KLGJ-së me shkresën nr. 45/24 prot. datë 19.05.2023 rezulton se: *Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr.9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimi e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar si dhe ligjin nr.96/2016 “Për statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, konstatohet se për kandidatin {...}: Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë; Nuk ka kryer fshehje të pasurisë; Nuk ka kryer deklarim të rremë; Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtëtit të gjyqtares, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUSIONE:

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtarja {...} duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtarit

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk u konstatua përdorimi i gjuhës diskriminuese apo tendencë për paragjykime gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjuha e përdorur është korrekte dhe i kushton rëndësi të veçantë rasteve me subjekte të mitur, subjekteve gra, si subjekte që gëzojnë mbrojtje të veçantë, si dhe personave të paaftë, të cilët janë me sëmundje mendore, për të cilët merr në konsideratë si orientim kryesor përmirësimin e shëndetit të tyre. Asnjë prej dokumentave ligjorë të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë dhe të pakicave. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese” në shkallë shumë të lartë.

KONKLUSIONE:

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit për gjyqtaren {...}, për vitin 2022, të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se ka pasur 2 kërkesa për përjashtimin e gjyqtares, të cilat janë rrëzuar të dyja. Gjithashtu sipas të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja ka hequr dorë në 1 (një) çështje, e cila është pranuar.

KONKLUZIONE:

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është zero, duke qenë se te dy kërkesat për përjashtimin e gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit janë rrëzuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, ky numër është “I pakonsiderueshëm”, dhe për këtë tregues gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se Gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, konstatohet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat

cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë.

Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

Gjyqtarja lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë, gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: *“Gjyqtarja aftësi shumë të mira komunikimi. Gjuha e përdorur prej saj është e qartë dhe e kuptueshme për palët, publikun dhe personat e tretë.”*

KONKLUSIONE:

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes për të qenë e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo të subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Nuk ka të dhëna negative, të cilat të kenë cenuar kujdesin për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ajo vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Në formularin e vetëvlerësimit profesional, gjyqtarja është shprehur se gjithmonë është përpjekur të tregojë kujdesin maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Sa i përket çështjeve gjyqësore të natyrës sensitive për shkak të informacioneve që përmbajnë, janë zhvilluar me dyer të mbyllura, sipas parashikimit të nenit 340 të K.Pr.Penale.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” në shkallë të lartë, gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: *“Gjyqtarja paraqet korrektësi maksimale, duke respektuar dhe mbrojtur të dhënat personale dhe konfidencialitetin e palëve në proces.”*

KONKLUSIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e aftësisë së gjyqtarëve për respektimin e konfidencialitetit dhe të mbrojtjes së të dhënave personale, është shumë e lartë.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarëve me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit.

Me shkresën me nr.2107/1 prot., datë 04.07.2023 rezulton se në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarëve {...}, nuk rezultuan të dhëna negative në lidhje me këtë tregues të aftësisë për të bashkëpunuar.

Gjyqtarja e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues, duke evidentuar se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit të saj me kolegët është në nivel maksimal, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale dhe përfshirjen në diskutime ligjore gjithashtu dhe Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Gjyqtarja ka komunikim etik dhe korrekt. Ajo është bashkëpunuese në ngritjen dhe diskutimin e problematikave të ndryshme ligjore ” duke e vlerësuar në një shkallë shumë të lartë këtë kriter.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarëve për këtë tregues është “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit sipas shkresës me nr.2107/1 prot., datë 04.07.2023, në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtarës {...}, nuk rezulton të dhëna negative në lidhje me komponentin e aftësisë për të bashkëpunuar me stafin e gjykatës.

Referuar formularit të integruar vlerësimit gjyqtarja ka parashtruar se: “Komunikimi me administratën gjyqësore ka qenë gjithmonë korrekt dhe bashkëpunues, në funksion të krijimit të një ambienti pune harmonik dhe produktiv.” dhe ka vlerësuar treguesin “shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore” në shkallë shumë të lartë.

Zv. Kryetari i Gjykatës ka deklaruar se: “Gjyqtarja ka marrëdhënie dhe komunikim etik dhe bashkëpunues me administratën gjyqësore.

KONKLUZIONE:

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga informacioni i përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 720/5, datë 13.10.2023;

Gjyqtarja {...}, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 ka marrë pjesë në aktivitetet trajnuese në cilësinë e pjesëmarrëses dhe te lehtësuese, të konvertuar në numër ditësh: 6.5 (gjashtë pikë pesë) ditë.”⁵⁰.

Në formularin e rezulton se në formularin e integruar të vlerësimit nga gjyqtarja ka deklaruar se: “Përveç pjesëmarrjes në një numër relativisht të lartë trajnimesh, në çdo rast mbi 5 trajnime në vit, pranë Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së rivlerësimit kam marrë

⁵⁰ Nga shqyrtimi në tërësi i shkresës, rezulton se Gjyqtarja ka marrë pjesë në 2.5 ditë si pjesëmarrëse, dhe dy ditë si lehtësuese, të cilat konvertohen në 3 ditë pjesëmarrje, pra në total 5.5 ditë, referuar nenit 55 pika 9 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës. Në çdo rast, Gjyqtarja subjekt vlerësimi rezulton të ketë plotësuar parashikimin në shkronjën “a”, pika 3 e nenit 5 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

pjesë aktive në seminaret e realizuara nga projekti suedez për implementimin e K.D.P.M dhe në datat 25-28 prill 2022 në seminarin e realizuar në Stockholm me qëllim evidentimin e problematikave praktike dhe sugjerimin e zgjidhjeve, përfshirë ndryshimet e kuadrit ligjor.”⁵¹

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, gjithsej 3 aktivitete të zhvilluara për 6.5 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve të parashikimit në shkronjën “a”, pika 3 e nenit 5 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

***Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime është 5.5 ditë, brenda marzhit të përcaktuar nga ligji 5-40 ditë për 1/vit, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

Referuar informacionit të përcjellë prej Shkollës së Magjistraturës me shkresën nr. 720/5, datë 13.0.12020 rezulton që subjekti i vlerësimit Gjyqtarja {...} ka marrë pjesë me cilësinë e lehtësueses për trajnimin e gjyqtarëve, në aktivitetin trajnues: «Kompetenca lëndore dhe dërgimi për këtë shkak në gjykatën kompetente. Vendimi i Prokurorit dhe konflikti i përgjithshëm për kompetencë. Lidhja ndërmjet kompetencës lëndore dhe pushimit të çështjes. Roli i gjykatës në këtë procedurë. Praktika gjyqësore e deritanishme.» , trajnim i zhvilluar në datat 21-22 Dhjetor 2022. (Prezent gjatë ditëve të trajnimit), si lehtësuese. Ndërsa në formularin e integruar të vlerësimit ajo ka parashtruar se :“*Gjatë periudhës së vlerësimit kam qenë në listën e Gjyqtarëve udhëheqës për kandidatët për magistrat, dhe kam udhëhequr rreth 8 kandidatë të vitit të dytë dhe të tretë. Njëkohësisht kam qenë në listën e lehtësuesve në trajnimin vazhdues të shkollës së Magjistraturës dhe kam marrë pjesë në një seminar trajnues dy ditor në këtë cilësi”.*

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto

⁵¹ Për të provuar këtë fakt, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka depozituar Ftesën për pjesëmarrje në aktivitetin e dytë “High Level Seminar on the implementation of the Code of Criminal Justice for Children (CCJC) during the first years of practice: Juvenile Sanctions, Precautionary Measures and the Juvenile Justice Case Law”, të organizuar në datat 25 -27 Prill 2022, në Stockholm.

veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren, duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUSIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lehtësues pranë Shkollës së Magjistraturës si dhe ka udhëheqë kandidatët për magjistratë gjatë stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, duke qenë se rezulton angazhimi i gjyqtarës, dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton që për periudhën e vlerësimit (01.01.2022-31.12.2022) gjyqtarja {...} ka paraqitur një shkresë të datës 13.06.2022 të Z. Jonas Hogstrom, Drejtor i Njësisë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, sipas të cilës: *Gjyqtarja ka qenë e përfshirë në disa hapa të zbatimit të Programit “The Albanian Swedish Juvenile Justice Programme”, e titulluar “Enhanced capacity of Albanian law enforcement agencies and Courts to meet human rights standards in juvenile justice – a comprehensive justice chain approach” e financuar nga Swedish International Development Cooperation Agency (SIDA).*

Në kuadër të këtij Programi, rezulton se Gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitetet: “High Level Seminar on the implementation of the Code of Criminal Justice for Children (CCJC) during the first years of practice: Juvenile Sanctions, Precautionary Measures and the Juvenile Justice Case Law”, 25 -27 Prill 2022, si dhe në Workshop përmbyllës të programit suedez për të mitur, datë 09.12.2022 në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë.

Bazuar në sa më sipër, referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUSIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera me një rol aktiv sipas përcaktimeve të metodologjisë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për këtë tregues, në kushtet kur rezulton angazhimi, gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezultojnë të dhëna. Me shkresën e datës 16.10.2023, protokolluar në KLGJ me Shkresën nr. 5383 Prot., datë 17.10.2022, Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka përcjellë kopje të botimit, ku është bashkëautore, në: “Përmbledhje e praktikës gjyqësore për Drejtësinë Penale për të Miturit, Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit në Gjykata 2018 -2021, Botimi i dytë, Maj 2022.” Botuar nga Programi Shqiptar Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur.

KONKLUZIONE:

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duket të vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezultojnë publikime të gjyqtarës dhe për pasojë pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Në këtë pjesë, relatori, bazuar në parashikimet e nenit 93, pika 5, shkronja “c” të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbi bazën e pikëzimit të kryer prej tij, propozon nivelin e vlerësimit për secilin nga katër kriteret e vlerësimit si dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit të gjyqtarit.

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	100	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	398	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR DHJETOR 2022

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë

					Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10%	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë

	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	+99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë

	<p>d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor</p>	<p>1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	<p>Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve-</p>	<p>15</p>	<p>Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë</p>
<p>B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore</p>	<p>a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive</p>	<p>1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p>	<p>1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë</p>	<p>15</p>	<p>Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë</p>

					1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	

A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues	Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia	
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë

	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	15-120 ditë (periudha 3/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë

		profesionale të saj			
KËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		398			
VELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		Shkëlqyeshëm			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR